



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **18.9.2023**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht më lejoni t'ju përshëndesë të gjithëve, nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtorive, përfaqësues te KFOR-it, medie dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen! E hapim mbledhjen e 9-të të **Komititetit për Politikë dhe Financa** për vitin 2023.

Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim – vendimit për shpalljen me interes te përgjithshëm publik P-01035-0, në Zonën Kadastrale Xërëx;
3. Shqyrtimi i propozim - vendimit për dhënien e Pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale P-0230-2, me pronën e institucionit qendror P-02240-1, për interes publik ZK-Rahovec;
4. Shqyrtimi i propozim - vendimit për ridestinim të mjeteve;
5. Shqyrtimi i propozimit - vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2024;
6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të Pronës se Paluajtshme të Komunës, sipas vendimit 01 Nr.23/23, i datës **27.04.2023**;
7. Informatë nga DKA-ja për përgatitjen për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024;
8. Informatë për muajin e mërgimtarëve, prej 15 korrikut, deri më 15 gusht 2023;
9. Të ndryshme;

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, të nderuar drejtore të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Atëherë, meqenëse është muaji i miratimit të buxhetit në seancën e ardhshme, kisha propozuar që drejtori i Financave të na sjellë një informatë shtesë që të na informojë mbi projektet që nuk janë të specifikuara në buxhetin e vitit 2024, vetëm që janë të ndara kodet dhe emërtimet e përgjithshme se ku do të ndahan mjetet, që ta kemi një informatë shtesë anëtarët e kuvendit, se cilat janë ato projekte saktësisht dhe të na sjellë më specifiksht, meqenëse nuk janë të përfshira në buxhet, pra që ta kemi si pikë shtesë për seancën e Kuvendit mbi projekte specifice jo ashtu siç janë në mënyrë të përgjithshme të përcaktuara në buxhet, pasi herën e kaluar jeni arsyetuar që sistemi nuk po ju lejon përfshirjen e projekteve specifice në buxhet, pasi në projektbuxhet kemi investime bashkë me donatorë qe e kam si kategori dhe cilat janë ato investime nuk kemi informata, kështu që duhet qe ta kemi një informatë mbi projektet se si do të ndahan mjetet në bazë të kategorive, qoftë si pikë shtesë apo pikës se projektbuxhetit, me pas të shkruar informatën mbi projektet specifice.

Fatmir Iska – I nderuar kryesues, te nderuar anëtarë të KPF-së, monitorues dhe gjithë ju të pranishëm, unë pajtohem me ju por ne veç e kemi një listë sa i përket projektbuxhetit dhe për pikë shtesë asnjëherë nuk ka pasur nevojë pasi e kemi listën dhe te gjitha janë të përfshira projektet në atë listë, sa i përket asaj që e përmende me projekte me donatorë, çdo herë ka qenë kodi edhe më herët, p.sh. gjatë 2024 mund të

vije ndonjë donator, derisa nuk e kemi të paraparë në buxhet dhe për këto arsyen ndahen mjetet që nëse paraqitet dikush apo ju aplikoni diku, i kemi mjetet e gatshme me kod dhe bashkëfinancon, përndryshe listën e projekteve për secilin projekt 2023-2026 do ta ketë secili anëtar i kuvendit. Pra, siç e kuptova kërkesën tuaj, p.sh., kodi: ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, apo ndërtimi i kanalizimit dhe pastaj kërkohet ajo më specifike, se kjo punë do të kryhet në këtë lagje me gjatësinë e caktuar dhe sigurisht se kjo mund të specifikohet mbi bazën e secilit drejtor që i ka shënimet brenda drejtorisë, pasi kërkesat i kemi pasur edhe më herët dhe sigurisht se është edhe më e arsyeshme dhe nuk krijon asnjë lloj problematike.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, e kalojmë në votim rendin e ditës. Me shumicën e votave të anëtarëve të KPF-së, miratohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Atëherë, meqë nuk kemi asnjë diskutim sa i përket procesverbalit, e hedhim në votim. Me shumice të votave, aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë:

2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes t; përgjithshëm publik P-01035-0, në Zonën Kadastrale Xërxe.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, anëtarë të KPF-së, kolegë drejtorë dhe të gjithë ju të pranishëm. Para jush keni propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-01035-0, në ZK në Xërxe, e cila gjendet konkretisht brenda parcelave të depove të Matrex-it, afér M-Sillosit dhe për shkak se kjo parcelë është në shfrytëzim të NBI Rahoveci dhe është në menaxhim të AKP-së dhe ne po kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm, më pas të shkojë në procedura të tjera të shpronësimit përfunksionalizimin e këtyre parcelave të tjera për shkak se në të njëjtën parcelë është ndërtuar Depo, të cilat komuna u jep me qira të interesuarve. Ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë për shpalljen me interes të përgjithshëm mbi pjesën e parcelës në fjalë.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime sa i përket kësaj pike, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, kalon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë:

3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale P-02302-0 me pronën e institucionit qendror P-02240-1 për interes publik ZK-Rahovec:

Afrim Oruqi – Sipas ligjeve në fuqi, kryetari i komunës, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa, dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë të institucionit qendror për interes publik. Bëhet fjalë për parcelën e cila gjendet skaj rrugës Rahovec-Malishevë, me sipërsfaqe prej 1 hektar, që është pronë që menaxhohet nga Agjencioni pyjor i Kosovës dhe ne po kërkojmë që t'i marrim pronësinë agjencionit pyjor dhe t'i japim të njëjtën sipërsfaqe, pjesë të komunës, në zonën e njëjtë në Rahovec, në afersi ku është e ndërtuar pishina “Shala”. Qëllimi i këmbimit është se nuk ekzistojnë parcelat e njëjta komunale t; përshtatshme për këtë qellim dhe pas këmbimit, bashkërisht me juve, do të caktojmë edhe priorititetet se për çka do të shërbejë kjo hapësirë. Kërkoi nga ju që të votoni propozimin për dhënien e pëlqimit për këmbim të pronës publike me pronë të institacioneve qendrore.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, meqë nuk kemi asnjë diskutim lidhur me këtë pike, e hedhim në votim. Me shumicë të votave, kalon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ridestinim të mjeteve:

Afrim Limani – I nderuar kryesues, nënkyetar, anëtarë të KPF-së dhe të gjithë ju të pranishëm. Ne do të shfrytëzojmë një mundësi ligjore për ridestinim të mjeteve, pasi faktikisht kemi menduar që rrezikohemi me shumën prej 60,722 euro. Këto mjete janë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike 40,722 dhe 20,000, nga të hyrat vetanake dhe këto kemi menduar t'i ridestinojmë në projekte të tjera. Sipas një udhëzimi të ri që ka dalë më herët, nëse një program apo një drejtori është përfituese brenda vitit fiskal, atëherë ajo s'ka të drejtë dy herë dhe si mundësi përbartjen e mjeteve me drejtori të tjera, si Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe këto mjete kemi menduar t'i ndajmë në kuadër të këtyre drejtorive si blerja e autoambulancës në Krushë të Madhe në shumen prej 9988 euro, mjete që i kemi borxh nga kontrata dhe renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në shumën prej 20,000 euro dhe shumën

30,724, i bartim në ndërtimin e rrugëve fushore Kramovik, Xerxe, Drenoc dhe Opterushë, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë dhe shuma për bartje është 60,722 euro. Kërkoi nga anëtarët e KPF-së të votohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, e hedhim në votim. Me shumicë të votave të anëtarëve të KPF-së kalon për kuvend kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i propozimit – vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2024:

Afrim Limani – Buxheti i Komunës, sipas qarkores së dytë, është pozicioni i pagave dhe i mëditjeve: 10,407 ,000 euro, mallra dhe shërbime: 2,466,000 euro, subvencione: 890,000, investime kapitale: 5,651,000, që në total bëjnë 19,804,000 euro. Faktikisht buxheti është 20,034,000, pasi i kemi edhe 240,000 në kuadër të shërbimeve rezidenciale por ato kategorizohen më veçantë në kuadër të qarkores dhe ato mjete janë tonat që sipas departamentit të buxhetit ato duhet të investohen për investime kapitale në kategorinë e personave me nevoja të veçanta. Sa u përket investimeve kapitale, Dëgjimet Buxhetore që i kemi mbajtur të gjitha, ato kërkesa që janë parashtruar nga qytetarët, janë të përfshira në kuadër të këtyre projekteve për investime kapitale, po ashtu, i kemi edhe disa kërkesa për rrethim të objekteve shkollorë, mirëpo ne kemi menduar që këtë projekt kapital ta vodosim me bartjen e mjeteve kah muaji shkurt, sepse sikur të futet në projekt, atëherë do të krijonte edhe çrrégullime buxhetore, kështu që do të ishte më mirë në kuadër të bartjes së mjeteve ta fusim këtë projekt për rrethimin e objekteve shkollorë.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutim sa i përket kësaj pike, e kalojmë për kuvend. Kalojmë në pikën e radhes:

6. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim, të Pronës së Paluajtshme të Komunës, sipas vendimit 01 Nr.23/23, i datës 27.04.2023:

Afrim Oruqi – Ne material e keni të bashkëngjitur vendimin e Kuvendit të Komunës, që bëhet fjalë për parcelën që gjendet në rrugën Rahovec-Suharekë, pronë e komunës, konkretisht aty ku ka operuar fabrika e kartonit, ku Kuvendi i Komunës, në seancat e kaluara, ka marrë vendim që për këtë pronë t'u bëjë thirrje personave fizik dhe juridik që ta marrin me qira ku janë vodosur edhe vitet, edhe shuma minimale për aplikim, po ashtu është formuar edhe komisioni që gjithashtu ia kemi bashkëngjitur edhe vendimin për formimin e komisionit së bashku me procesverbal, që realisht para jush keni vendimin sipas ligjeve në fuqi, të propozuar sipas aplikimit që ka qenë vetëm një aplikues, i cili ka ofertuar me çmimin e ofertës që ka qenë 550 euro dhe ofertuesi ka aplikuar me shumën 570 euro dhe bëhet fjalë për firmën EuroBeg, me seli në Mamushë, rruga Kisla Mahall, të cilën e përfaqëson Naser Morina nga Mamusha, që jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 25 vjet, pronë e paluajtshme e komunës, zona Hoçë e Madhe, sipas certifikatës së pronës 266-0, me sipërfaqe të përgjithshme: 1 hektar 99 metra katror, duke përshirë zyrat administrative dhe objekti me sipërfaqe prej 2000 metra katror, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovcit dhe afati për shfrytëzim është nga 1.12.2023 dhe përfundon më 30.12.2048 dhe pas përfundimit të këtij afati apo ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet komunës së Rahovcit. Kështu që i ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë propozim-vendimin sipas shkresës.

Kryesuesi – Atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera sa i përket pikës që prezantoi drejtori, e hedhim në votim. Me shumicë të votave kalon, edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Informatë nga DKA-ja për përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024

Avni Morina – Përshëndetje kryesues, nënkyetar, kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të KPF-së dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Me këtë informatë kemi pasqyruar përgatitjet dhe problemet që kemi pasur për fillimin e vitit të ri shkollor 2023/2024. Gjithashtu e kemi cekur faktin se gati pas 3 vjetëve patëm mundësi ta fillojmë vitin shkollor më 1 shtator, për shkak të problemeve që i kemi pasur në të kaluarën me pandeminë dhe me grevën. Kam pasqyruar të gjitha aktivitet që kemi ndërmarrë para fillimit të vitit të ri shkollor, po ashtu, kemi përmendur faktin se vetëm dy shkolla nuk kanë mundur ta fillojnë mësimin më 1 shtator për shkak të riparimit dhe me problemet e eficiencës, pastaj faktin e organizimit të trajnimeve për mësimdhënësit e ri në fushat e ndryshme kurrikulare gjatë muajit gusht, pastaj rastin e problemit sa i takon

furnizimit me libra për shkak të vendimit të ministrisë, pastaj angazhimet tona që kemi pasur për t'i ndihmuar prindërit për furnizim me libra për nxënësit, pastaj mbajtjen e afatit të dytë të provimit të maturës dhe gjithashtu edhe regjistrimin e nxënësve për klasat e dhjeta që janë mbajtur më 22, 23, 24 gusht. Gjithashtu kemi përmendur edhe problemin e mosfurnizimit të tri çerdheve publike me inventarë dhe akoma nuk është bërë furnizimi nga Ministria e Arsimit dhe për shkak të mungesës së inventarit, çerdhet ende nuk janë funksionalizuar.

Leonard Morina – Unë po kërkoj që këtij materiali t'ia bashkëngjitni për shkak që regjistrimet e klasave të dhjeta veçse kanë përfunduar dhe të bëhet një krahasim i viti të kaluar me këtë vit, a ka mungesë të nxënësve dhe a ka mësimdhënës që ka mbetur pa normë për shkak të mungesës së nxënësve. Gjithashtu, edhe për shkollat fillore, ky vit shkollar a i ka të gjithë kuadrot e përbushur për të filluar viti shkollar dhe nëse ka mungesë të kuadrove në lëndë të caktuara, do të ishte mirë të theksohen për raste të caktuara.

Avni Morina – Në informatë e kam përmendur faktin se Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit gusht, është marrë me planifikimin e kuadrit mësimor në të gjitha nivelet, jo vetëm në shkollat fillore, por edhe në shkollat e mesme të larta, por ndërkohë kanë ndodhur edhe zhvillime të tjera, pasi në kohen kur është përpiluar informata, nuk kanë qenë të disponueshme, prandaj edhe këtë informatë do ta plotësojmë për mbledhje të Kuvendit, me informata të tjera me gjitha problemet dhe angazhimet e tjera që kemi pasur ne procesin e fillimit te viti te ri shkollar.

8. Informatë për muajin e mërgimtarëve, prej 15 korrikut, deri më 15 gusht 2023:

Afram Dina – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së dhe të gjithë të pranishëm! Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si bartëse e të gjitha aktiviteteve për muajin e mërgimtarëve, ku siç e keni edhe para vetes, e kemi pasqyruar mbarëvajtjen e të gjitha aktivitetave nga 15 korriku, deri më 15 gusht, apo siç e kemi quajtur edhe si Ditët e Mërgatës, ku kemi pasur shumë aktivitete që janë pritur jashtëzakonisht mirë nga qytetarët, ku kemi pasur mundësi për shumë takime reciproke me mërgimtarët dhe njëherit kemi organizuar shume turne, si në futboll, shah dhe koncerte, ku njëherit kemi pasur shumë ndeja me mërgimtarët, të njohura si “Sofra e mërgimtarit”. Po ashtu, kryetari i komunës, z. Smajl Latifi, ka pritur në zyrën e tij shumë mërgimtarë, rreth jetës dhe veprimtarisë së atyre në mërgatë dhe mundësisë së investimeve të mërgimtarëve që kanë bizneset e tyre në mërgatë. Kemi pasur 16 aktivitete si në qytet dhe vendbanimet e komunës sonë, që shumica e tyre janë mbajtur në rrugën “Xhevat Kasapi”, në bashkëpunim me të gjitha bizneset që operojnë aty dhe aktivitetet janë pritur shumë mirë nga qytetarët, po ashtu kemi pasur edhe Agrofestën, që është mbajtur më 5 dhe 6 gusht në Krushë të Madhe, pastaj turneun në shah dhe futboll në Ratkoc. Pra, gjithashtu duhet ta potencojmë edhe bashkëpunimin me policinë e Kosovës në Rahovec, për bashkëpunimin dhe sigurinë e ofruar për qytetarët edhe për shumë aktivitete të tjera që janë mbajtur në Gradish, Çifllak, Opterushë etj. I falënderoj të gjithë qytetarët tanë për pjesëmarrjen dhe organizimin e mirë që kemi pasur pa ndonjë incident të vogël!

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha këto informata dhe të gjitha aktivitetet që kemi pasur, atëherë, meqë nuk kemi diskutime të tjera, kalojmë në pikën e radhës:

9. Të ndryshme:

Pasi nuk kemi diskutime sa i përket kësaj pike, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e konstatoj të mbyllur këtë mbledhje dhe shihemi në mbledhje të tjera.

Mbledhja përfundoi: 11:00

Procesmbajtësi:

Agim Hoti



K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni